



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.933/6 prot.

Datë 05.05.2025

V E N D I M

Nr. 607/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiovent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Medi - Tel” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-38381-02-18-2025, me objekt: “Shërbimin e trajtimit dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 24 (njëzetë e katër)” me fond limit 12,375,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale Berat.

Ankimues: Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK me NIPT L61814009B dhe adresë: Pasuria Nr. 1070, Zona Kadstrale 3965, Metalurgji, Bradashesh, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Rajonale Berat
Lagjia “Kushtrim”, Berat.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Medi - Tel” SHPK me NIPT J71519004Ë dhe adresë: Kashar, MEZEZ, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Rruga Vidhegjate, Nderresa Nr.18, Zona Kadastrale Nr.2679, Nr.pronesie 41/, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 19-02-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-38381-02-18-2025, me objekt: “Shërbimin e trajtimit dhe asgjësimit e mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 24 (njëzetë e

katër)” me fond limit 12,375,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale Berat.

II.2. Në datë 13.03.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 02.04.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si më poshtë:

MEDI – TEL SHPK	10.575.000.00	I kualifikuar
Eco Riciklim	11.880.000.00	I kualifikuar

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në datën 03.04.2025 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak ku është shpallur fitues operatori ekonomik “Medi Tel” shpk.

II.5. Në datën 09.04.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5223 si dhe nr. Protokolli 933/2025 datë 09.04.2025 i operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-38381-02-18-2025, me objekt: “Shërbimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 24 (njëzetë e katër)” me fond limit 12,375,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale Berat. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Medi - Tel” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit. Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime se operatori ekonomik “Medi Tel” shpk nuk përmbush kriteret e ku përcaktohen : 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.5- Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt ne DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores “Per menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- *Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente).*
- *Impiant/e për asgjësimin me incenerim.*
- *Makineri për larjen e kontenierëve (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm)–*
minimalisht copë 1 (nje)

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- *Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);*

- *Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm duhet të jenë të pajisur me;*

- a) a.1. *Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për implantet për asgjësimin me incenerim*
- a.2. *Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për implantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;*
- b) *Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit implant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme.*
- c) *Deklaratë Konformiteti CE i secilit implant dhe makinerie.*

**Shënim nr. 1: KVO rezervon të drejtën e verifikimit në terren lidhur me funksionimin e proceseve të punës për pajisjet sa më sipër.*

**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

- *Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi brenda afatit të vlefshmerisë.*

**Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

II.6 . Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.933/1 prot, datë 10.04.2025 , lidhur me kundërshtimin e vendimit

të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK , në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka operatorë ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, si në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike

II.8. Në datën 17.04.2025 me shkresën nr.2146 nëpërmjet SAE autoriteti kontraktor ka dërguar informacion kjo e fundit protokolluar me tonen N 93/2 date 17.04.2025 , me lende “Procesverbal mbi shqyrtimin e ankeses me objekt “Sherbimin e trajtimit dhe asgjесimin e mbetjeve spitalore per nje periudhe 24 mujore” referuar ktij info ka bashklidhur kthim pergjigjen dhe venidmin Nr 2146/1 datë 17.04.2025 ku vendosi refuzimin e ankesës.

II.9 Në datën 17.04.2025 me shkresën nr.2146/2 në forme shkresore autoriteti kontraktor ka dërguar informacion kjo e fundit protokolluar me tonen N 93/2 date 17.04.2025 , me lende “Procesverbal mbi shqyrtimin e ankeses me objekt “Sherbimin e trajtimit dhe asgjесimin e mbetjeve spitalore per nje periudhe 24 mujore” referuar ktij info ka bashklidhur kthim pergjigjen dhe venidmin Nr 2146/1 datë 17.04.2025 ku vendosi refuzimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton;

III.1. Lidhur me pretendim e operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” shpk, për kundërshtimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi Tel” SHPK, me arsyetimin se: nuk përmbush kriterin e publikuar në shtojcën 1 datë 13.02.2025 për modifikimin e DT ku përcaktohet: *Sipas informacionit të verifikuar nga përvoja jonë në procedura të ngjashme dhe njohjes së tregut, rezulton se OE imedi Telë sh.p.k. Nuk e plotëson këtë kërkesë thelbësore, pasi nuk ka paraqitur një kontratë të drejtpërdrejtë me një landfill të licencuar dhe të pajisur me Leje Mjedisore përkatëse për depozitimin e mbetjeve finale me kodet 19 03 dhe 19 01. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga vetë operatori ekonomik, rezulton se: ? OE imedi Telë sh.p.k. Ka lidhur një Akt-marrëveshje me subjektin igant Constructionë sh.p.k., për depozitimin e mbetjeve përmes këtij subjekti, në landfillin ibrema Ambienteë sh.p.k., i cili është i pajisur me Leje Mjedisore të Tipit A, nr. Identifikimi 3806/6, prot. Nr. 1284, datë 18.02.2025. ? Megjithatë, kjo marrëveshje nuk përmbush kriterin 2.3.8, për arsyet në vijim: 1. Mungon kontrata direkte me landfillin e autorizuar Kriteri kërkon kontratë të lidhur me subjektin që disponon Lejen Mjedisore, pra landfillin përfundimtar që pranon mbetjet. NË rastin konkret, marrëveshja është e lidhur me një ndërmjetës (igant Constructionë), i cili nuk është as vetë landfill dhe as nuk zotëron leje për pranim mbetjesh të trajtuara me kodet përkatëse. Ky ndërmjetësim*

nuk garanton kontrollin e drejtpërdrejtë dhe përgjegjësinë e OE për trajtimin përfundimtar të mbetjeve, siá kërkohet nga kriteri. 2. *Ëgant Constructionë sh.p.k.* Nuk është subjekt i autorizuar nga AKM Subjekti me të cilin është lidhur marrëveshja: ? Nuk ka statusin e landfillit të licencuar, dhe ? Nuk zotëron Leje Mjedisore aktive për pranim mbetjesh me kodet 19 03 dhe 19 01. Kjo përbën një mospërputhje të hapur me kërkesat e kriterit 2.3.8, i cili parashikon qartësisht që leja përkatëse duhet të jetë në emër të subjektit me të cilin është lidhur kontrata, jo e një subjekti tjetër ku mbetjet përfundimisht dërgohen nga ndërmjetësi. 3. Mospërputhja ekzistonte në momentin e hapjes së ofertave Dokumentacioni që justifikon përmbushjen e kriterit duhet të jetë i plotë, i qartë dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave. Marrëveshja e paraqitur nuk përmbush këtë kusht, pasi nuk provon se OE imedi Telë sh.p.k. Kishte akses të drejtpërdrejtë dhe të garantuar në një subjekt të licencuar dhe të autorizuar për depozitimin e produkteve finale të trajtimit, sipas kodifikimeve të përcaktuara në kriter., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar DST të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

- Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit të vlefshmerisë.

**Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

III. 1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Medi Tel” shpk në përmbushje të kriterit sa më lart ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Akt Marrëveshje Nr.147 prot datë 26.06.2024 për depozitim mbetjesh pranë “Brema Ambiente” shpk përmes menaxhuesit “Gant Construction” shpk, lidhur ndërmjet shoqëria “Gant Construction” shpk menaxhues i mbetjeve, “Medi Tel” shpk gjenerues dhe transportues i mbetjeve dhe shoqëria “**Brema Ambiente**” shpk **pritësi i mbetjeve** (Park & landfill industrial), ku me kode cer 1901 Mbetje nga inceneratorët ose piroliza e mbetjeve

- Akt Miratimi NR 1284 Prot, datë 18.02.2025 Leje Mjedisi e tipit A e subjektit “Brema Ambiente” shpk (landfill i mbetjeve), leshuar nga AKM.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që

operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Referuar pretendimeve në ankesë, ankimuesi pretendon se subjekti “GANT Construction” shpk me të cilin operatori ekonomik “Medi Tel” shpk ka lidhur akt marrëveshje nuk ka statusin e landfillit të licensuar dhe nuk disponon leje mjedisore të vlefshme për pranim produktesh përfundimtare nga procesi i trajtimit me teknologji pa djegie dhe me teknologji me djegie incinerim.

Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi i mbetjeve, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit). Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin: Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi brenda afatit të vlefshmërisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik “Medi Tel” shpk se në përmbushje të këtij kriteri ka dorëzuar dokumentin Akt Marrëveshje të lidhur mes tre palëve e konkretisht mes subjektit “Gant Construction” shpk në cilësinë e menaxhuesit të mbetjeve, “Medi Tel” shpk në cilësinë e gjeneruesit dhe transportuesit të mbetjeve dhe subjektit **“Brema Ambiente” shpk në cilësinë e pritësit të mbetjeve** (Park & landfill industrial). Gjithashtu operatori ekonomik “Medi Tel” shpk ka dorëzuar dokumentin Akt Miratimi, leje Mjedisi e tipit A e subjektit “Brema Ambiente” shpk (landfill i mbetjeve).

Sa më sipër rezulton se subjekti “Brema Ambiente” shpk shfaqet në cilësinë e pritësit të mbetjeve ndërkohë që subjekti “Gant Construction” shpk në akt marrëveshje ka vetëm rolin e menaxhuesit të mbetjeve i cili do të faturojë dhe kryejë menaxhimin për depozitimin e mbetjeve pranë vend depozitimit të shoqërisë Brema Ambiente shpk. Në këto kushte KPP gjykon se, në rastin konkret subjekti i cili duhet të jetë i pajisur me licencat dhe lejet përkatëse është subjekti “Brema Ambiente” shpk ku rezulton se në rastin konkret i disponon ato duke përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu referuar sa me sipër lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se “*. . Gant Construction sh.p.k. Nuk është subjekt i autorizuar nga AKM Subjekti me të cilin është lidhur marrëveshja: ? Nuk ka statusin e landfillit të licensuar, dhe Nuk zotëron Leje Mjedisore aktive për pranim mbetjesh me kodet 19 03 dhe 19 01*”. Citojme se referuar argumentimit si me sipër nga ana e KPP shprehet qartë se, subjekti pra landfilli I licensuar që duhet të ketë leje mjedisore për pranim mbetjesh është **Brema Ambiente SHPK** si priti I depozitimit të mbetjeve, Ndaj pretendimi juaj se Gant Contruction SHPK nuk është subjekt I autortizuar nga AKM pranim mbetjesh me kodet 19 03 dhe 19 01 nuk merret parasysh, pasi është subjekt tjetër ai I cili përmbushë këtë kriter.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendim e operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” shpk, për kundërshtimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi Tel” SHPK, me arsyetimin se: *Sipas të dhënave të marra nga QKB dhe informacionit të publikuar në Lejen Mjedisore të operatorit, rezulton se OE medi Telë sh.p.k. Përdor për asgjësimin me incenerim impiantin model ËFS-150, prodhim i kompanisë kineze Shandong Better Environmental Protection Technology Co., Ltd. Ky produkt është i përshkruar në faqen zyrtare të prodhuesit: <https://ëëë.sdbetter.net/Hospital-Ëaste-Incinerator-pd882405.html> NË kuadër të verifikimeve tona gjate studimit te tregut per te tilla pajisje, ky impiant nuk është i shoqëruar me një deklaratë Konformiteti CE, të lëshuar nga prodhuesi, sic kërkohet shprehimisht në kriterin*

2.3.5. ? NË faqen e sipërpërmendur, si dhe në seksionin e dedikuar të certifikatave të kompanisë prodhuese: <https://ëëë.sdbetter.net/Certificate.html>, nuk figuron Deklarata CE për këtë model. ? NË treg qarkullojnë dokumente shtesë të lëshuara nga subjekte të treta si kompania turke UDEM, e cila ka lëshuar një certifikatë pajtueshmërie me direktivën e Makinerive 2006/42/EC. Megjithatë, kjo certifikatë: - Nuk është deklarata Konformiteti CE; - NË vetë tekstin e saj specifikon se marka CE mund të përdoret nën përgjegjësinë e prodhuesit vetëm pas plotësimit prej tij të deklaratës së Konformitetit CE me Direktivat përkatëse.ë. - Në faqen e UDEM që ka lëshuar këtë certifikatë: <https://ëëë.udem.com.tr/en/belge-sorgulama>, nga kerkimi me emrin e kompanisë Shandong Better dhe me numrin M.2020.206.C4925, rezulton se ajo ka skaduar në datë 10.03.2025, pra në datën e paraqitjes së ofertave ka qene e skaduar. ? Gjithashtu, kjo certifikatë mbulon vetëm një nga direktivat përkatëse (Machinery Directive), ndërkohë që një deklarata e vlefshme CE për këtë kategori impianti duhet të mbulojë edhe Direktivat CE në vijim: 2. BS EN 746-2:1997 (Pajisje termike) 3. Loë Voltage Directive 73/23/EEC 4. EMC Directive 89/336/EEC 5. (EC) No 1005/2009 mbi substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit Pra, mungesa e deklaratës së Konformitetit CE për këtë incenerator përbën një mospërmbushje të drejtpërdrejtë të kriterëve teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit. NË rrethanat e mësipërme, vlerësohet se OE Medi-Tel nuk e plotëson kriterin 2.3.5 në lidhje pasjen e deklaratës së Konformitetit CE për njërin nga implantet (inceneratorin) dhe ky duhet konsideruar si shkak për skualifikim. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5- Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, implant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt në DST, sipas Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Per menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenerëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- Implant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente).
- Implant/e për asgjësimin me incenerim.
- Makineri për larjen e kontenerëve (vetëm në rastin kur do të përdoren kontenerë të ripërdorshëm)– minimalisht copë 1 (një)

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- Implantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht **makineritë** për larjen dhe dezinfektimin e kontenerëve te ripërdorshëm duhet të jenë të pajisur me;

a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për implantet për asgjësimin me incenerim

- a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, **ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme.**
- c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*

**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “Medi Tel” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit
- Faturë Doganore 1 cp Incenerator Tip ËFS-150
- Kremetor për mbetje i mbyllur të serive ËFS, Shandong Better Enviromental Protection Technology co ltd, Certifikata e vërtetimit të direktivës së makinerisë për prodhuesin Shandong Better Enviromental Protection Technology co.ltd., Direktiva e makinerisë 2006/42 EC lëshuar nga Udem International Certification lëshuar ne datë 03.03.2025 dhe me date skadimi 03.03.2030.
- Faturë Doganore, Autoklavë për trajtimin e mbetjeve mjekësore komplet me aksesore 1 copë.
- Autoklava Ecodas T 300, Certifikata CE 0035 e vërtetimit të direktivës së makinerisë për prodhuesin Ecodas lëshuar nga TUV Rheinland.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë,

pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si

dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

II.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.5. Referuar sa më lart KPP vëren se në kriterin e veçantë kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar dokument që vërteton se operatori ekonomik pjesëmarrës *qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt ne DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores “Per menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:*

- *Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente)*

- *Impiant/e për asgjësimin me incenerim.*

- *Makineri për larjen e kontenierëve (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm)—minimalisht copë 1 (nje) për të përballuar sasinë e mbetjeve spitalore objekt i këtij prokurimi, të provuar me dokument që provon pronësinë apo disponimin me qera në një nga mënyrat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi); Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht **makineritë** për larjen*

dhe dezinfektimin e kontenierëve te ripërdorshem duhet të jenë të pajisur me nder te tjera Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Medi Tel" shpk në përmbushje të këtij kriteri KPP vëren se ky i fundit ka dorëzuar dokumentacion edhe sa i takon Inceneratorit edhe Autoklaves duke përmbushur kështu në mënyrë kumulative kriterin. Ankimuesi pretendon se për inceneratorin nuk është paraqitur certifikata CE e prodhuesit. Ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar certifikata CE është lëshuar për të dy prodhuesit përkatësisht të Inceneratorit dhe Autoklavës. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor sqarohet se kompania UDEM International Certification është një trupë turko kroate e njohur dhe e regjistruar zyrtarisht pranë Komisionit Evropian si Notified Body. Sipas rregullave të BE certifikatat e lëshuara nga trupat e Notified Body janë të vlefshme për certifikimin CE. Në bazë të rregullave të Komisionit Evropian çdo trupë e regjistruar në listën e Notified Bodies ka autoritetin për të lëshuar certifikata CE. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Komisionit Evropian shpk rezulton se kjo kompani si një Notified Body e regjistruar në këtë listë ka të drejtën ligjore të kryejë vlerësimin e konformitetit dhe të lëshojë certifikata CE për pajisjet industriale, duke përfshirë edhe impiantet e incenerimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Eco Riciklim" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur", me Nr. REF-38381-02-18-2025, me objekt: "Shërbimin e trajtimit dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 24 (njëzetë e katër)" me fond limit 12,375,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale Berat.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik "Eco Riciklim" SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

